



Biografi e shkurtër

Eglantina Baku, Këshilltare Ligjore

Zj. Eglantina Baku (Lala) është diplomuar në vitin 2003 në shkenca juridike pranë Universitetit “Aristoteli”, Selanik, Greqi. Në vitin 2009 përfundoi studimet “Master në Ligje (LLM) në të Drejtën e Shoqërive Tregtare”, pranë “University College London (UCL)”, Mbretëri e Bashkuar.

Ka një përvojë pune prej rreth 14 vitesh, me angazhime profesionale në sektorin publik dhe atë privat. Në vitin 2004 filloi punë pranë Ministrisë së Drejtësisë, ku shërbeu për rreth 8 vite në pozicionet e specialistit të marrëdhënieve me jashtë dhe atë të specialistit në Drejtorinë e Legjislacionit dhe Asistencës Ligjore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Koodifikimit.

Eksperienca e saj pranë sektorit privat daton në mars të vitit 2012, kur filloi punë pranë shoqërisë ajrore shqiptare “Belle Air” si drejtuese e Departamentit Ligjor. Nga tetori i vitit 2013 deri në shtator të vitit 2015, punoi për kompaninë ndërkombëtare “British American Tobacco-Albania” si Menaxhere për Çështjet Ligjore, Rregullatore dhe Korporative për Njësinë e Biznesit të Adriatikut dhe Ballkanit Jugor, duke mbuluar njëkohësisht tregjet e Shqipërisë, Kosovës, Bosnje-Hercegovinës, Sllovenisë dhe Maqedonisë. Nga janari i vitit 2016 deri në korrik të vitit 2017, zj. Baku është angazhuar si konsulent i lartë ligjor pranë Shoqërisë ABKONS, duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh konsulente në disa sektorë të industrisë, përfshirë edhe Administratën Publike. Në nëntor të vitit 2016 bashkëthemeloi një zyrë avokatore, të cilën edhe e administroi deri në janar të vitit 2018.

Ka fituar titullin “Avokat” dhe është anëtare e Dhomës Kombëtare të Avokatisë që nga viti 2013. Zotëron gjuhën angleze, greke dhe atë italiane.

Nga janari 2018, zj. Baku iu bashkua Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, si Këshilltare Ligjore.